



Pranuar / Dorezuar Prenjelo / Predato Received / Delivered	02. 11. 2020	0	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br / Pr / I Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTFK	2393/2020		1/4



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.273/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.273/2020 të datës 17.09.2020 e parashtruar nga ankuesja [REDACTED] me adresë rruga "Ndue Perlleshi", Mati 1 OB-Hyrja 1 NR.27, në Prishtinë, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës-transferim" kundër organit të punësimit Inspektorati i Arsimit në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, si dhe duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 02.11.2020, mori këtë:

### V E N D I M

- I. **Aprovohet** pjesërisht si e bazuar ankesa A.nr.273/2020 e datës 17.09.2020, e parashtruar nga ankuesja [REDACTED].
- II. **Shfuqizohet** vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Arsimit në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës i datës 22.09.2020 NR. ref. 10/628.
- III. **Detyrohet** Drejtori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Arsimit në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, që brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh të ndërmerr të gjitha veprimet për zbatim të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

### A r s y e t i m

Drejtori i Përgjithshëm në Inspektoratin e Arsimit, më datë 24.06.2020, ka iniciuar procedurë disiplinore sipas fletëparaqitjes me numër protokolli 1378 tek Komisioni Disiplinor, ndaj ankuses [REDACTED],



në pozitën e punës „Inspektore e Arsimit”, në Drejtorinë e Përgjithshëm në Inspektoratin e Arsimit, për shkak të tejkalimit dhe keqpërdorimit të autoritet zyrtar.

Me datë 07.08.2020, ankuesja ka parashtruar ankesë më Nr. Protokolli 179 në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, ku përveç pretendimeve tjera, ka parashtruar edhe pretendimin ankimor kundër mos nxjerrjes së vendimit nga Komisioni Disiplinor sipas fletëparaqitjes së Drejtorit të Përgjithshëm me numër protokolli 1378 të datë 24.06.2020.

Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, nuk ka lëshuar vendim sipas ankesës së datës 07.08.2020.

Ankuesja me datës 17.09.2020 ka parashtrua ankesë përmes E-mailit zyrtar në adresën elektronike të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokolli 1806/2020, me pretendime ankimore për mos veprim të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës si dhe mos veprim të Komisionit Disiplinor të kësaj Ministrie. Ndërsa me datë 22.09.2020 ankuesja po përmes adresës elektronike të Këshillit, ka dërguar parashtrësë plotësuese kundër vendimin Nr. Ref.10/ 628 të datës 22.09.2020 për transferimin e ankuese në vendin bazë në SIA Ferizaj.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 25.09.2020, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inspektoratin e Arsimit. Më datë 15.10.2020 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Inspektorati i Arsimit në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, me shkresat përcjellëse.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1806/2020 të datës 17.09.2020 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; provat shtese të datë 17.09.2020 me nr. protokolli 1811; Kërkesë e datës 30.09.2019 nga (prindi i nxënësit); Kërkesë e datës 10.09.2020 për rishqyrtim; Dëftesë nr.163/19; Aktvendim i datës 18.09.2019; Kërkesë e datës 21.10.2019; Njoftim i datës 28.10.2019; Procesverbal i datës 29.11.2019; Përgjigje e datës 20.01.2020 sipas kërkesës nga Avokati i Popullit; Përgjigje e datës 14.01.2020; Ankese e datës 07.08.2020 në Komisionin për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave; Vendim i datës 14.02.2020 nga Inspektorja e arsimit; Shqyrtim ankesës për nxënësin Qazim Dervishi; Procesverbali i datës 22.05.2020; Ankesa e datës 14.01.2020 nga Avokati i Popullit; Prova shtese nga ankuesja me E-mail të datës 24.09.2020 nr. protokolli 1874, E-mail me prova shtese me nr. protokolli 1888, të datës 23.09.2020; Raport i datës 11.09.2020; Vendim nr.ref.10/nr.628 i datës 22.09.2020; E-mail me prova shtese të datës 22.09.2020 me nr.protokolli 1586/2020; Fletëparaqitje e datës 24.06.2020 për komision disiplinor; Kërkesa e datës 06.05.2020; Njoftim i datës 16.06.2020 Vendim i datës 22.05.2020; Ankesa (e prindit) e datës 22.06.2020; Pasqyra e ditarit të notave; E-mail i datës 15.06.2020; E-mail i datës 12.06.2020; E-mail i datës 11.06.2020; E-mail i datës 17.04.2020; Email i datës 16.04.2020; E-mail 24.02.2020 të datës 23.01.2020 dhe të datës 21.02.2020; Prova shtese nga ankuesja me E-mail të datës 18.09.2020 nr. protokolli 1815/2020, rezultatet përfundimtare nga Gjimnazi i Specializuar Matematikor në Prishtinë; Certifikata e datës 11.04.2019; raport pune; E-mail i datës 23.01.2020; Përgjigje në ankese e datës 15.10.2020; Kërkesë e datës 21.01.2019 për shpallje të konkursit; Aplikacion i datës 30.01.2009; Komente të datës 08.08.2008; kopje konkursi; Kontratë e datës 28.04.2009 e punës nr. 01/2009; Propozim për miratim të komisionit intervistues i datës 02.03.2009; Lista e aplikacioneve e datës 17.03.2009; lista nga konkursi për Inspektor në Prishtinë; Lista e aplikantëve për intervistë; Procesverbali i datës 20.03.2009 nga intervista; Miratimi i raportit final i datës 26.03.2009; E-mail i datës 03.11.2009;

Miratimi i kërkesës për [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] e datës 28.04.2011; Vërejtje me shkrim e datës 24.07.2018; Vendimi datës 26.03.2020; prova shtesë të datës 29.10.2020; Akte Emërimi i datës 06.06.2012; E-mail i datës 25.02.2020; Përgjigje e datës 12.05.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar së pretendimet ankimore të ankueses janë pjesërisht të bazuara, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen ankesave, ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankueses për mos veprim të Komisionit Disiplinor dhe Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, janë jo relevante për vendosje lidhur me ankesën.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në Akt Emërimin e datës 06.06.2012, ka konstatuar se ankuesja [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] është e punësuar pa afat në pozitën e karrierës“ Inspektore e Arsimit”, në Departamentin e Inspektoratit të Arsimit në Ministrinë e Arsimit në Prishtinë, tani Inspektorati i Arsimit.

Bazuar në përcaktimin ligjor sipas nenit 126 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji për shqyrtim të ankesave, parashtrësën e ankueses të datës 22.09.2020 kundër vendimit Nr. Ref.10/ 628 të datës 22.09.2020 për transferimin e ankueses në vendin bazë në SIA Ferizaj, i nxjerr nga Drejtori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Arsimit pas parashtrimit të ankesës në Këshill, e konsideroj si pretendim ankimor kundër këtij vendimi dhe si të tillë e shqyrtoj sipas ankesës A. Nr.1806 të datës 17.09.2020.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në mandatin ligjor dhe kushtetues konstaton së vendimi i datës 22.09.2020 nr. Ref. 10/628 lidhur me transferimin e ankueses në SIA Ferizaj, është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe nenin 4 të Rregullores (QRK) NR. 14/2020 Për Transferimin Nëpunësve Civilë sepse në këtë vendim nuk është saktësuar periudha e transferimit të përkohshme ashtu siç përcaktohet me këto dispozita ligjore “Neni 52 ....Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve; 1.2. për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj gjatë 2 vjetëve” .

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar vendimin e atakuar me ankesë mbi transferimin e ankueses, ka konstatuar se arsyetimi i vendimit është i paqartë dhe nuk përmban sqarime të mjaftueshme lidhur me shkaqet që kanë sjellë nxjerrjen e këtij vendimin, andaj si i tillë është në kundërshtim me nenin 48 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se “ ..... Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij “.

Bazuar në rrethanat faktike dhe juridike të lartcekura, Komisioni për shqyrtim të ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A.nr.273/2020**

**Zyle Millaku Gojnovci**

**Zyrtarë e Lartë për Bashkëpunim Profesional**

**Ardita Haxhnikaj - Demi**

**Kryetare e Kolegjit**



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses [REDACTED];
- Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Arsimit në Ministrinë se Arsimit dhe Shkencës
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë se Arsimit dhe Shkencës
- Gjykatës Themelore, Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë
- Arkivit të KPMSHCK-së.

